



PSH.nr.650/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenkovic - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Osa Termosistem” SH.P.K - Rahovec, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik “IBM”; “Majlinda Bajraktari B.I.” - Mitrovicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me enë-pajisje për zierjen e ushqimit” me nr. të prok: 632-20-3933-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjakovë”, më datën: 08.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Osa Termosistem” SH.P.K -Rahovec, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me enë-pajisje për zierjen e ushqimit” me nr. të prok: 632-20-3933-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK-Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me enë-pajisje për zierjen e ushqimit” me nr. të prok: 632-20-3933-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK-Gjakovë, dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Osa Termosistem” SH.P.K -Rahovec, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “Osa Termosistem” SH.P.K -Rahovec, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 10.09.2020 me nr. 650/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “IBM”; “Majlinda Bajraktari B.I.” - Mitrovicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me enë-pajisje për zierjen e ushqimit” me nr. të prok: 632-20-3933-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjakovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.09.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 24.09.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Osa Termosistem” SH.P.K –Rahovec

Përgjigje ne pretendimin ankimor nr.1

Në bazë të dosjes së tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me licenca ISO- ISO 9001 të jete valide, sistemi i menaxhimit të kualitetit dhe ISO-22000 të jetë valide – Sistemi i menaxhimit të sigurisë ushqimore.

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Operatoret ekonomik duhet të jene të pajisur me licenca ISO valide (kopje).

Në bazë të dokumentacionit të prezantuar nga AK, OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar certifikatën ISO 22000 dhe si rrjedhojë kompania e shpallur fituese, nuk i plotëson kriteret teknike dhe/ose profesionale,

dhe si e tillë është dashur të shpallet e papërgjegjshme. Këtë fakt e ka pranuar edhe AK, mirëpo këtë e konsideron si devijim i vogël.

Ndërsa sipas legjislacionit në fuqi mungesa e një dokumenti që është edhe kriter në dosje të tenderit mund të kërkohej sqarim nga OE dhe i njëjti nëse nuk e dorëzon brenda afateve kohore OE në fjalë shpallet i papërgjegjshëm. Gjithashtu, thuhet se AK nuk e ka shfrytëzuar të drejtën që i jep ligji që të kërkojë sqarime nga OE për të siguruar informata shtesë dhe të vendos në bazë të atyre informatave dhe dosjes së tenderit të dorëzuara nga OE.

Kërkojmë nga OSHP që lëndën ta kthejë në rivlerësim dhe të bëjë vlerësimin e saktë dhe të drejtë të gjithë OE.

Gjithashtu duhet theksuar se ky është RI-TENDER, ku edhe në tenderin e parë ka pasur shkelje të legjislacionit në fuqi, ku është pranuar në RI-SHQYRTIM ankesa e OE i cili fare nuk ka dorëzuar tender dhe si i tillë nuk është palë e interesit. AK e ka anuluar tenderin duke u bazuar në kërkesën e OE i cili nuk ka qenë palë e interesit.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr, 2

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kriterin e kërkuar të AK-së në FDT dhe Njoftim për kontratë; -Kërkesa

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca ISO - ISO 9001 të jetë valide, Sistemi i Menaxhimit të Kualitetit dhe ISO-22000 të jetë valide - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore. – Dëshmia: Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca ISO valide- (kopje)

Eksperti profesional i prokurimit sqaron se lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar nuk i plotëson certifikatat ISO 22000, në dosjen e tenderit të OE të rekomanduar nuk u has Certifikata e tij, që nënkuptohet se OE nuk e plotëson kriterin e kërkuar. AK sipas nenin 72 të LPP-së dhe nenit 39.8 të RRUOPP-së ti kërkojë sqarime shtesë për Certifikatat ISO 22000 në fazën e rivlerësimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna më lartë), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa të aprovohet e bazuar, të anulohet Vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në rivlerësim, dhe të respektohen kriteret e kërkuara nga vet AK si në FDT dhe NJK.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 25.09.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 25.09.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 26.09.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “Osa Termosistem” SH.P.K –Rahovec, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit që ka të bëjë me certifikatën ISO 22000 dhe AK e ka shpallur fitues.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se ky pretendim ankimor është i bazuar për faktin se në tenderin e OE të rekomanduar për kontratë mungon certifikata ISO 22000. Andaj, AK me rastin e vlerësimit të ofertave do duhej të kërkonte sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Pra, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit profesional të prokurimit, vjen në përfundim se AK me rastin e ekzaminimit të tenderëve ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njëherit nuk ka pasur parasysh nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet autoriteti kontraktues që me rastin e ri vlerësimit të ofertave të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe pastaj të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve konform dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Gjithashtu, Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Për më tepër, Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve

publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK -"KK-Gjakovë";
- 1x1 OE "Osa Termosistem" SH.P.K – Rahovec;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.